



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË TELEVISIONEVE “REPORT TV” DHE “NEWS 24”
PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën 00.04.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat e:

KËRKUES: Televizioni “Report TV”, Rruga Ndre Mjeda, Tiranë, me përfaqësues znj. Vilma Theodhosi

Televizioni “News 24”, Ish - Uzina e Autotraktorëve në Tiranë, me përfaqësues z. Robert Rakiplari

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të medias për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



Për miratimin e përfaqësuesve të mediave Report TV dhe News 24 për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023

V Ë R E J:

Televizioni "Report TV" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 64 (gjashtëdhjetë e katër) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "Report TV" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni "News 24" i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 51 (pesëdhjetë e një) gazetarë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Televizioni "News 24" është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

V E N D O S A:

1. Akreditimin e gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 64 (gjashtëdhjetë e katër) gazetarëve të televizionit "Report TV", sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Akreditimin e gazetarëve për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 të 51 (pesëdhjetë e një) gazetarëve të televizionit "News 24", sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv

Nr:
Ora: hh:mm



Për miratimin e përfaqësuesve të mediave "Report TV" dhe "News 24" për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023